



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
SEKTORI I AUDITIT TË BRENDSHËM

Nr. 1080 prot.

Tiranë, më 15.02.2018

Lënda: Dërgohet raporti vjetor i veprimtarisë për vitin 2017.

DREJTORISË SË HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Tiranë

Në zbatim të pikës ç,të nenit 14, të ligjit nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe “Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, miratuar me Urdhërin nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave, Kapitulli IV, pika 4.3 e tij “*Raportimi vjetor i veprimtarisë së NjAB tek titullari i subjektit publik dhe Strukturës përgjegjëse për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm*”, bashkëngjitur do të gjeni Raportin Vjetor të veprimtarisë për vitin 2017, pasqyrat shoqëruese të raportit dhe pyetësorin e vetëvlerësimit për Auditimin e Brendshëm, miratuar me Vendimin e Komitetit të Auditit të Brendshëm nr.3, datë 15.02.2017 “Për monitorimin e performancës së Sektorit të Auditimit të Brendshëm”, (vendimi bashkëngjitur).

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,



Konc.A.Toqj,

Adresa: Rruga “Aleksandër Moisiu”, nr. 76, ish-kinostudio “Shqipëria e Re”, Tiranë

Email: info@kultura.gov.al

www.kultura.gov.al

RAPORT
MBI
VEPRIMTARINË E SEKTORIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM
NË
MINISTRINË E KULTURËS
PËR VITIN 2017

HYRJE

Në zbatim të pikës ç, të nenit 14, të ligjit nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe “Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, miratuar me Urdhërin nr 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave, Kapitulli IV, pika 4.3 e tij “Raportimi vjetor i veprimtarisë së NjAB tek titullari i subjektit publik dhe Strukturës përgjegjëse për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm”, Sektori i Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Kulturës (në vijim MK), ka përgatitur dhe ju paraqet Raportin Vjetor të veprimtarisë së tij për vitin 2017.

Në mënyrë të përmbledhur rezultatet e saj paraqiten sa poshtë vijon :

I. Përmbledhje Ekzekutive

Raporti Vjetor mbi Veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm të Ministrisë së Kulturës, fokusohet në drejtimitet e mëposhtme:

Së pari: Ky raport paraqet përgjegjshmërinë e realizimit të programit të auditimit. Ai trajton menaxhimin e burimeve, treguesit dhe matësit e performancës, si dhe shkallën e pajtueshmërisë me standartet profesionale të auditimit. Rezultatet dhe produktet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, janë të pasqyruara në raportet e auditimit të dërguar në cdo institucion.

Së dyti: Komunikon rezultatet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm publik dhe tregon qeverisjen dhe shërbimin publik në institucione.

Raporti përçon problemet më të rëndësishme të identifikuara dhe të trajtuara, tregon ecurinë drejt përmirësimeve të vazhdueshme dhe veprimeve korrigjuese, si dhe sfidat e përpjekjet e pandërprera, për të siguruar pajtueshmërinë me kuadrin legjislativ të parashikuar në aktivitetin ekonomik e financiar.

Raporti, përshkruan statusin, autoritetin, strukturën organizative dhe burimet e njësisë së auditimit, ai përvijon procesin e planifikimit mbi bazë risku.

II. Baza Ligjore

Kuadri ligjor dhe procedural i auditimit të brendshëm përfaqësohet nga:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Ligji nr. 114, datë 22.10.2015, “Pë auditin e brendshëm në sektorin publik”

Manuali i Auditimit të Brendshëm Publik dhe Manualin Specifik të MK;

Karta e Auditimit të Brendshëm Publik”

Kuadri i Praktikave Profesionale Ndërkombëtare, i cili përmban Standartet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm dhe Praktikave Profesionale të publikuara nga IIA.

Ligji mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin publik;

III. Organizimi

• Misioni i auditimit të brendshëm

Misioni i Njesisë së Auditimit në MK është të japë siguri të arsyeshme për titullarin e njesisë, garantimi i zbatimit të ligjshmërisë në përdorimin e fondeve publike dhe forcimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm. Shtimin e vlerës së institucioneve publike në përputhje me drejtimit kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe me programin e Këshillit të Ministrave në fushën e kulturës e të trashëgimisë kulturore.

NJAB e ka kryer veprimtarinë e saj në zbatim të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, "Pë auditin e brendshëm në sektorin publik" dhe akteve të dala në zbatim të tij, të cilët përbëjnë parimet dhe kërkesat themelore për praktikat profesionale të auditimit të brendshëm.

• Organizimi i NjAB

Njësia e Auditimit të Brendshëm ka funksionuar si Drejtori në varësi të Ministrit sipas strukturës së miratuar nga Kryeministri me Urdhër nr. 66, datë 07.04.2016" Për miratimin e strukturës dhe të organikës së MK" i ndryshuar me Urdhërin nr. 179, datë 28.12.2016 dhe përbëhet prej 5 vetë, 1 drejtor dhe 4 specialist. Organika e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm ka rezultuar e paplotësuar në 1 specialist.

Me Urdhër të Kryeministrit nr. 164, datë 05.10.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së MK", Njësia e Auditimit të Brendshëm është organizuar në Sektor dhe përbëhet prej 3 vetë, 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialist. Sektori i Auditimit të Brendshëm është i paplotësuar për pozicionin "përgjegjës sektori".

Specialistët janë me arsim të lartë për shkenca ekonomike.

Struktura e miratuar është si vijon:

Përgjegjës Sektori	1
Specialist audit	2

Të gjithë specialistët në njësinë e Auditimit të Brendshëm janë pajisur me çertifikatën "Auditues i brendshëm në sektorin publik". Specialistët e auditit kanë ndjekur procesin e trajnimit vjetor prej 40 orësh, të organizuar nga Njësia Qëndrore e Harmonizimit për Auditimin të Brendshëm.

Në zbatim të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, "Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik" dhe VKM nr.140, datë 02.03.2016, "Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësinë publike" me Urdhër të Ministrit nr.16, datë 10.01.2018 "Për ngritjen e Komitetit të Auditimit", është ngritur Komiteti i Auditimit.

IV. Rezultatet e Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm

• Analiza e programeve të auditimit për periudhën raportuese

Në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 "Pë auditin e brendshëm në sektorin publik" dhe të Kapitullit III, të Manualit të Auditimit të Brendshëm miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik", veprimtaria audituese është orientuar në vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efektivitetin e sistemeve të kontroleve, duke u fokusuar kryesisht në:

- ❖ identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga titullari i njësisë publike;
- ❖ përputhshmërinë e veprimtarisë së njësisë publike me kuadrin rregullator;
- ❖ ruajtjen e aseteve;
- ❖ besueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e informacionit financiar dhe operacional;
- ❖ kryerjen e veprimtarisë së njësisë publike me ekonomi, efektivitet dhe eficiencë;
- ❖ përmbushjen e detyrave dhe arritjen e qëllimeve;
- ❖ duke dhënë rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike;

Kryerja e angazhimeve të auditimit të brendshëm është bërë në zbatim të programit vjetor miratuar nga Titullari i MK me nr. 5063/1, datë 14.10.2016 “Plani vjetor dhe strategjik 2017-2020”, ku janë planifikuar 14 misione auditimi me bazë sistem. Llogaritja për numrin e planifikimit të misioneve të auditimit është bërë duke patur parasysh strukturën me burimet njerzore, me 4 specialist.

Për periudhën raportuese janë realizuar 14 misione auditimi me bazë sistemi, realizuar në masën 100%. Gjatë vitit plani vjetor 2017 ka patur 1(një) devijim. Auditimi i planifikuar për tu kryer në Aparatin e Ministrisë ishte planifikuar të realizohej në 3-mujorin e IV të vitit 2017. Auditimi i Aparatit të MK është në proces auditimi nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Me kërkesë të titullarit është realizuar misioni i auditimit në Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit.

Përveç misioneve të auditimit me bazë sistem, SAB në zbatim të kapitulli IV, pika 4.1.13 të Urdhërit nr.100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e manualit të Brendshëm në Sektorin Publik”, në institucionet e varësisë ka kërkuar informacion mbi progresin që është bërë për zbatimin e rekomandimeve të lëna dhe të rëna dakord, sipas afateve të përcaktuara në plan veprimet.

Planifikimi dhe realizimi i programit të auditimit për vitin 2017, paraqitet:

Nr.	Llojet e auditimit	Të planifikuara	Të realizuara	Realizimi në %
1	Me bazë sistemi	14	14	100

Në 2 subjekte, Muzeu Kombëtar “Gjergj Kastrioti Skërdërbeu” dhe Muzeu Etnografik dhe në Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit, misioni i auditimit është në proces.

Në Muzeun Kombëtar “Gjergj Kastrioti Skërdërbeu” dhe Muzeu Etnografik kanë përfunduar të gjitha fazat e auditimit. Për titullarin e institucionit është pregatitur materiali informues në formën e Memos dhe materiali për përfundimet e angazhimit dhe janë në proces shqyrtimi dhe miratimi nga Titullari. Në Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit ka përfunduar puna në terren dhe grupi i auditit ka pregatitur projekt raportin, të cilin ia ka paraqitur Titullarit.

Për institucionet e mësipërme për të cilat nuk kanë përfunduar të gjitha procedurat e auditimit, gjetjet e tyre nuk janë raportuar në pasqyrat përkatëse.

Gjatë vitit 2017 kanë përfunduar dhe 4 misione auditimi të deklaruara në proces në raportimet e vitit 2016. Në përfundim të angazhimit në të 4 institucione janë lënë 27 rekomandime organizative. Nga ndjekja e tyre ka rezultuar zbatimimi në masën 63%, rekomandime në proces në masën 26% dhe të pa realizuara në masën 11%.

Për realizimin e planit vjetor në grupet e auditimit janë përfshirë dhe specialistë të drejtorive të përmbajtjes në MK, sipas objektit të auditimit dhe fushës së veprimit.

- **Fushat me risk më të lartë dhe trajtimi i tyre**

Planet Strategjike dhe Vjetore të Auditimit të Brendshëm janë pregatitur mbi bazën e riskut duke identifikuar dhe vlerësuar, risqet kryesore për veprimtarinë e institucioneve. Vlerësimi i riskut është bërë sipas problematikave të paraqitura nga titullarët e institucioneve në takimet e zhvilluar, analiza e raporteve vjetore, raportet e auditimeve të mëparshme dhe në disa raste është mbështetur mbi strategjinë e riskut të hartuar nga institucionet.

Nga analiza e raporteve vjetore individuale si dhe nga intervistat e realizuara, rezulton se përcaktimi i nivelit të riskut, është bërë duke marrë në konsideratë faktorët e riskut, të cilët në mënyrë të përmbledhur do të përgjithësoheshin në kategoritë e mëposhtme:

- ❖ Sasia dhe përdorimi i burimeve në dispozicion të institucionit të audituar;
- ❖ Zbatimi i ligshmërisë, politikave, procedurave, rregulloreve e planeve;
- ❖ Arritja e objektivave dhe rezultateve të pritshme;
- ❖ Ruajtja dhe miradministrimi i aseteve pronë publike;
- ❖ Kërkesat e raportimit financiar;
- ❖ Mjedisi i kontrollit;
- ❖ Shkalla e ndryshimeve organizative dhe në drejtim;
- ❖ Mbulimi i pamjaftueshëm me auditime në të kaluarën

Bazuar në faktorët e përmendur më sipër, vlerësojnë me risk më të lartë fushat në vijim:

- ❖ Sistemet e menaxhimit financiar. Pjesa më e madhe e të audituarve gjykojnë se pikërisht menaxhimi financiar është fusha ku risku është më i pranishëm. Po t'i referohemi analizës në seksionin “Gjetjet më të rëndësishme” të këtij raporti, janë pikërisht fushat e: prokurimeve publike, pagave, transaksioneve financiare, mbledhjes së të ardhurave dhe taksat, në të cilat janë zbuluar dhe shkeljet më të rëndësishme.
- ❖ Investimet për restaurimin e objekteve të trashëgimisë kulturore, ku përfshihet jo vetëm zbatueshmëria e kuadrit ligjor, por edhe shkalla e cilësia e implementimit të kontratave. Këto fusha, shfaqen jo vetëm me risk të lartë financiar, por dhe operacional, që ka të bëjë me cilësinë e punimeve.

Duke u bazuar në përcaktimin e fushave me risk më të lartë, sa më sipër, struktura audituese ka vendosur dhe prioritetet e saj. Kështu, në subjektet apo fushat me risk më të lartë, janë angazhuar të gjitha burimet e auditimit me kohë të gjatë auditimi, që do të thotë që në këto auditime janë përfshirë staf më nivel të lartë profesional dhe është siguruar kohë e mjaftueshme për vlerësimin e subjekteve. Në auditime me risk, ka marrë pjesë dhe drejtuesi i DAB.

- **Gjetjet e kryesore sipas sistemeve:**

Gjatë procesit të auditimit të brendshëm, menaxhimi është informuar mbi gjetjet e auditimit. Raportimi i gjetjeve të punës tek menaxhimi dhe lënia e rekomandimeve për të përmirësuar funksionimin e tyre, është një nga pjesët më të rëndësishme të procesit të auditimit të brendshëm.

Nga institucionet ka patur reagime pozitive në lidhje me zbatimin e rekomandimeve. Me dërgimin e raportit final në cdo institucion, kemi informuar titullarin mbi përfundimin e cdo misioni auditees.

Bazuar në gjetjet e rezultuara sipas auditimeve me bazë sistemi, për përmirësimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe të organizimit të kontrollit të brendshëm, për vitin 2017, janë dhënë gjithsej 58 rekomandime nga të cilat 17 rekomandime janë realizuar që i perket në masën 29% dhe 41 rekomandime janë në proces realizimi në masën 71%. Rekomandimet në proces janë në përqindje të lartë pasi në 3 institucione (Teatri I Operas, Baletit dhe Ansambli Popullor, QKIPK, Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Kombëtar-Apolloni) ku janë lënë 23 rekomandime, misionet e auditimit kanë përfunduar dhe janë miratuar në fund të vitit 2017. Rekomandimet janë pranuar nga titullarët e institucionit dhe janë përcaktuar dhe afatet e realizimit të tyre. Rekomandimet të ndara sipas prioritetit i paraqesim si vijon:


- Për përmirësimin e sistemit 1 rekomandime
- Për përmirësimin e kuadrit ligjor 1 rekomandime
- Të karakterit organizativ 53 rekomandime
- Rekomandime për arkëtim 3 rekomandime

Rekomandimet të ndara sipas sisteme i paraqesim më poshtë:

- Sistemin i administrimit të pronës, pasurisë 4.
- Sistemin i prokurimit, blerjeve dhe investimeve 7.
- Sistemin i pagesave, shpërblime... 1.
- Sistemin të tjera 44.
- Sistemet e privatizimit, shitjes dhe qiradhënies 1.
- Sistemet e tatimeve, taksave dhe doganave 1

Grafikisht paraqiten :

Sistemin i administrimit të pronës, pasurisë	Sistemin i prokurimit, blerjeve dhe investimeve	Sistemin i pagesave, shpërblime	Sistemet e privatizimit, shitjes dhe qiradhënies	Sistemet e tatimeve, taksave dhe doganave	Sistemin të tjera
4	7	1	1	1	44




Për vitin 2015 janë adresuar 47 rekomandime, për vitin 2016 janë adresuar 66 rekomandime dhe për vitin 2017 janë adresuar 58 rekomandime.

Gjetjet e mëdëm ekonomik në vlerën 984 mijë lekë i përkasin parregullsive në sistemin e prokurimeve dhe blerjeve në 2 institucione ku është konstatuar dëmi në vlerën 684 mijë lekë dhe të paga, shpërblime, trajnime në 1 institucion është konstatuar dëmi në vlerën 300 mijë lekë.

Ecuria e gjetjeve në 3 vitet e fundit në nivel vjetor paraqitet si vijon (në mijë lekë):

Nr.	Vlera e gjetjeve	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017
1	Sistemi paga, shpërblime, trajnime	1046	388	300
2	Administrimi I pronës		218	
3	Sistemi i Prokurimeve, blerjeve			684
	Gjithsej	1046	606	984

Në mënyrë grafike i paraqesim si mëposhtë:



Vlera e gjetjeve me dëm ekonomik, në krahasim me vitin 2016 është në rritje.

- **Vlerësimi i sistemeve të Kontrollit të Brendshëm**

Raportimi i brendshëm efektiv për drejtuesin është një bazë e mirë për monitorimin dhe zgjerimin e kontroleve menaxheriale për të përmirësuar sistemet.

Është përgjegjësi e drejtuesit krijimi i një sistemi të mirëfilltë efikas kontrolli i brendshëm. Ndonëse ka filluar të kuptohet roli dhe rëndësia e vet-vlerësimit të organizatës nga menaxhimi,

ky detyrim ligjor nuk është përmbushur nga të gjitha institucionet.

Këshillat shkencor dhe Artistik në institucionet e artit dhe trashëgimisë të cilët kanë rol mbikëqyrës dhe vendimarrës nuk e luajnë rolin e tyre aktiv, për të identifikuar mangësitë e mundshme me qëllim marrjen e masave përmirësuese. Nuk monitoroj dhe kërkojnë rezultate gjatë ekzekutimit të planeve apo aktiviteteve. Këto dobësi janë konstatuar në të gjitha institucionet e kulturës dhe trashëgimisë.

Dobësit menaxheriale, financiare dhe të zbatimit të kontrollit të brendshëm të pasqyruara në raportet e auditimit, tregojnë se koncepti i MFKB ende nuk është kuptuar sa duhet nga institucionet e varësisë. Dopsitë e sistemi të MFKB tregojnë mangësitë e hasura si në planifikim dhe ekzekutim të buxhetit, delegim dhe ndarje të detyrave, planifikim dhe realizim të të ardhurave, menaxhim të personelit, menaxhim të pasurisë dhe detyrimeve, mangësitë në raportimin dhe konsolidimin e PBA. Ato kanë tendencë rritje dhe përmirësimi të vazhdueshëm në shumë fusha të financave dhe operative. Me gjithë të arriturat, institucionet vazhdojnë të ballafaqohen me sfida nga më të ndryshmet. Buxheti i limituar në raport me nevojat reale kanë pasur efektin e vet. Ndikim në këtë ka dhe numri i vogël i personelit që kanë disa institucione.

Një analizë më e thellë e nevojave specifike të secilit institucion është e nevojshme para se të përcaktohen kufijtë buxhetor. Kjo do mundësonte një shpërndarje racionale të buxhetit Aktivitetet e organizatave të audituara në përgjithësi nuk janë sa duhet efikase dhe efektive. Shumica e institucioneve nuk kanë statut dhe rregullore të detajuara që mbulojnë aktivitetet e përditshme të ndërlidhura me MFKB.

Raportimet e dobëta menaxheriale bëjnë që vendimmarrja dhe reagimi për përmirësimet e nevojshme të jetë I vonuar.

Kërkesat buxhetore për furnizime, shërbime dhe punë, në të shumtën e rasteve vlerësohen në mënyrë të përgjithësuar dhe vetëm në vlerë financiare, pa ndonjë analizë të mirëfilltë dhe prioritizim të nevojave, dhe pa ndonjë specifikim konkret rreth sasisë së furnizimeve. Karakteristikë është se për çdo vit kanë kërkesa të ngjashme buxhetore vit pas viti, sidomos për mallra e shërbime, pavarësisht plotësisht të nevojave përgjatë viteve. Vështirësitë janë evidente edhe në investime.

Sfidë e institucioneve vazhdon të jetë menaxhimi i riskut, ky një komponent kyçe i MFKB. Institucionet, në përgjithësi, nuk kanë procedura të dokumentuara në menaxhimin e riskut, nuk identifikojnë, analizojnë, vlerësojnë dhe as nuk ndërmarrin veprime për të menaxhuar riskun në arritjen e objektivave të tyre.

Nga titullarët e institucioneve nuk janë hartuar plane për trajnime për të rritur performancën në punë.

Si përfundim ka ende mjaft për të bërë me qëllim që shpenzimi i parasë publike të bëhet në mënyrë ekonomike, efikase dhe efektive .

V. REKOMANDIMET

Rekomandimet e adresuara nga DAB japin kontribut në përmirësimin e kontrolleve në ndihmë të procesit të qeverisjes dhe shfrytëzimin sa më të mirë të burimeve në dispozicion. Gjatë auditimeve të ushtruara sipas planit vjetor 2017 ne kemi analizuar mënyrën se si janë adresuar rekomandimet tona dhe progresin e bërë për realizimin e tyre.

Shkalla e implementimit të rekomandimeve të kaluara, pra të lëna nga auditimet e mëparshme, në nivel institucional akoma nuk është e kënaqshme, përkundër faktit se ka përmirësime me kalimin e viteve. Kjo ka ndikuar që një numër i konsiderueshëm i rekomandimeve të përsëriten edhe në auditimet e ushtruara gjatë vitit 2017. Në zbatimin jo të plotë të rekomandimeve ka ndikuar mungesa e veprimeve të duhura nga menaxherët e institucioneve.

Rekomandimet e dhëna bazuar në natyrën e gjetjeve janë për përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, ndreqjen e parregullsive, parandalimin e shpërdorimeve dhe shkeljeve, ruajtjen e aseteve publike, çdëmtimin e vlerave për dëme të shkaktuara nga persona përgjegjës ose të përfituara padrejtësisht.

Rekomandimet më të rëndësishme që ende nuk janë realizuar janë:

- Përfundimi i procesit të hartimit dhe miratimit të statuteve dhe Rregulloreve të Brendshme për pjesën më të madhe të institucioneve,
- Menaxhimi i burimeve njerëzore. Niveli i ulët profesional i punonjësve, ka ndikuar negativisht në arritjen e objektivave dhe cilësinë e punës.
- Hartimi i rregjistrit të riskut sipas përcaktimeve të kreut III “Identifikimi i risqeve” të “Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.
- Planifikim më i saktë i buxhetit, për shpenzimet operative dhe monitorimi i realizimit të tyre, pasi në disa institucione, rezultojnë detyrime në fund të vitit, ndaj furnitorëve për blerje dhe shërbime, që kanë tejkaluar fondet e vitit ushtrimor.
- Mungesa e miratimit të tarifave sipas propozimeve të bëra nga institucionet e artit dhe të trashëgimisë.
- Mungesa e të akteve nënligjore dhe statuteve në zbatim të kërkesave të Ligjit “Për Artin dhe kulturën”.
- Arkivimi i dosjeve të prokurimeve me vlera të larta dhe arkivimi i dosjeve të projekteve artistike.
- Mungesa e akteve nënligjore
- Mungesa e zbatimit të plotë të Gjurmës së Auditit.
- Emërimi i nëpunësit zbatues si nëpunës me varësi direkte nga titullari, përgjegjës për menaxhimin e aktiveve.
- Sigurimi i objekteve të trashëgimisë Kulturore me vlera unike dhe Kombetare.

Pjesë e punës tonë gjatë kryerjes së auditimeve, është edhe monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të dhëna në vitet paraprake. Është e njohur, që përgjegjësia e zbatimit të rekomandimeve, rëndon mbi vetë drejtuesit e subjekteve të audituara, por nga ana tjetër, përgjegjësia e auditimit të brendshëm, nuk kufizohet vetëm në dhënien, por edhe në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, pasi dhe rezultatet e punës audituese, varen në një masë të madhe nga zbatueshmëria e tyre.

Në zbatim të pikës 4.1.13 “Ndjekja e rekomandimeve” të manualit të auditimit të brendshëm SAB ka kryer ndjekjen e rekomandimeve në 12 institucione të varësisë dhe kemi analizuar mënyrën se si janë adresuar rekomandimet dhe realizimin e tyre.

Rezultatet nga këto analiza i kemi përmbledhur në tabelat e mëposhtme

	Institucionet	Rekomandimi dhënë	Rekomandimi pranuar nga menaxhimi	Rekomandimi zbatuar	Në proces zbatimi	Pa realizuar
1	Agjencia e Shërbimit Arkeologjik	6	6	6		
2	Teatri kukullave	3	3	2	1	
3	Qendra Kombëtare e Kultures	8	8	7	1	
4	Qendra Kombëtare e Kinematografise	8	8	7	1	
5	Qendra kombetare e Vemprimitarive Folklorike	3	3	3		
6	Biblioteka kombetare	3	3	2	1	
7	Qendra Kombëtare e Muzeve, Berat	4	4	2	2	
8	QNK "Arbnori"	11	11	8	2	1
9	IMK "Gani Strazimiri"	4	4	2	2	
10	Muzeu Historik Kombetar	9	9	6	2	1
11	DRKK, Gjirokaster	6	6	3	3	
12	Teatri kombëtar	12	12	4	5	3
	Shuma	77	77	52	20	5

Sic shihet nga tabela numri total i rekomandimeve të adresuara është 77 rekomandime. Realizimi i tyre është në masën 68% ndaj totalit të rekomandimeve, në proces zbatimi janë në masën 26% dhe të pa realizuar në masën 6%.

VI. Monitorimi i Sistemit dhe Sigurimi i Cilësisë.

Për të rritur cilësinë e auditimeve në vitin 2017 është kryer në vazhdimësi rishikimi i punës së audituesve.

Referuar procedurave të përcaktuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm sqarojmë se, rishikimi dhe vlerësimi i cilësisë për materialet e auditimit (raportet paraprake, raportet finale, memo etj) është realizuar gjatë procesit të auditimit, nga përgjegjësi i grupit dhe Drejtori i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm. Megjithatë duhet pranuar se në drejtim të përmirësimit të cilësisë dhe të zbatimit të standarteve të auditimit, gjithnjë ka vend për përmirësim.

Nga drejtuesi është bërë rishikimi i cilësisë duke bërë shqyrtimin e raporteve të auditimit dhe dokumentave të tjera të administruara në secilën dosje të auditimit.

Gjatë planifikimit të grupit të punës që merr pjesë në një mision auditimi, është vlerësuar performanca, përvoja dhe kualifikimet e gjithsecilit. Gjithashtu detajimi i hollësishëm i programit të auditimit ka qenë prioritet gjatë punës. I gjithë procesi i auditimit është mbikqyrur rregullisht duke respektuar programin e auditimit dhe trajtimin e problemeve që mund të lindin gjatë një program auditimi.

VII. Analiza e Kapaciteteve Audituese

Për vitin 2017, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka qenë e organizuar në Drejtori me 5 vetë, 1 drejtor dhe 4 specialist. Organika e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm ka rezultuar e paplotësuar në 1 specialist.

Me Urdhër të Kryeministrit nr. 164, datë 05.10.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së MK", Njësia e Auditimit të Brendshëm është organizuar në Sektor dhe përbëhet

prej 3 vetë, 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialist. Sektori i Auditimit të Brendshëm është i paplotësuar për pozicionin “përgjegjës sektori”.

Arsimi bazë për punonjësit e auditimit është profesioni ekonomist dhe të gjithë punonjësit janë të certifikuar sipas kërkesave ligjore.

Kanë përmbushur detyrimin për kryerjen e 40 orëve trajnim të përditësuar në fushën e auditimit sipas njoftimeve të NJQH/AB dhe e kanë përfunduar me sukses vlerësimin e njohurive. Njohuritë e marra gjatë trajnimeve i ka vënë në zbatim dhe kanë patur ndikim të dobishëm në performancë.

Fuqizimi i strukturës do të ishte një zgjidhje e mirë për rritjen e cilësisë së punës.

VIII.Konkluzione

↓ Konkluzione mbi problematikën e punës audituese

Kapacitetet menaxhuese të institucioneve kanë tendencë rritje dhe përmirësimi të vazhdueshëm në shumë fusha të veprimtarisë së tyre. Edhe përmbushja e kërkesave ligjore për raportim financiar është evidente. Me gjithë të arriturat, institucionet vazhdojnë të ballafaqohen me sfida nga më të ndryshmet. Buxheti i limituar në raport me nevojat kanë pasur efektin e vet. Një analizë më e thellë e nevojave specifike për secilin institucion është e nevojshme para se të përcaktohen kufijtë buxhetor.

Marrja e angazhimeve përtej fondeve në dispozicion e në disa raste mungesa profesionale në vlerësimin e nevojave buxhetore nga vet ato, vështirësojnë zhvillimin normal të veprimtarisë. Ngecjet në adresimin e rekomandimeve, kanë bërë që parregullsitë të përsëriten vit pas viti. Aktivitetet menaxheriale duhet të kenë fokus të veçantë monitorimin dhe realizimin e projekteve me kohë dhe përmbushjen e planeve dhe objektivave.

Në disa raste kontrollet e brendshme nuk ishin efikase në administrimin dhe menaxhimin e pasurisë. Institucionet nuk kishin evidenca të plota për aktivet që administrojnë. Kjo kishte reflektim negativ edhe në raportimin financiar dhe me ndikim në opinionet e auditimit. Kontrolli i brendshëm dhe delegimi i detyrave dhe përgjegjësisë është një nga sfidat kryesore me të cilat po përballen disa institucione. Ndikim në këtë ka patur numri i vogël i personelit që kanë këto institucione.

↓ Prioritetet për vitin e ardhshëm

- Garantimi i zhvillimit të veprimtarisë audituese në përputhje me praktikat më të mira profesionale.
- Menaxhimi efektiv i burimeve të auditimit, bazuar në aftësitë profesionale si dhe përmes koordimit me auditimin e jashtëm
- Të realizojë veprimtarinë audituese të orjentuar nga vlerësimi i riskut dhe në shërbim të menaxhimit;
- Përmirësimi i sistemit të programimit dhe metodologjisë së vlerësimit të riskut sipas sistemeve, me qëllim garantimin e një efience sa më të lartë, në përputhje me fushën për auditim.
- Ritja e nivelit të cilësisë së punës audituese dhe profesionalizmi i audituesve duke patur impakt të drejtpërdrejtë në forcimin e rolit dhe pozitive të auditimit pranë Institucionit.
- Ritja e nivelit të shërbimit të auditimit duke synuar kompetencë të lartë, objektivitet maksimal dhe standarte të larta etike;
- Rritja e cilësisë së Raportimit, duke respektuar standartet në fushën e raportimit lidhur me cilësinë, qartësinë dhe dobishmërinë;

- Mirëmenaxhimi I burimeve njerëzore me elementin kohë, duke respektuar etapat e auditimit që nga puna përgatitore deri në evadimin e plotë të materialeve.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Punoi: Aida TOQI



Realizimi i planit të angazhimeve për vitin 2017

Në numër

Nr	Subjekte të audituara nga NJAB	Realizimi i angazhimeve të auditimit										Statusi i Angazhimit				
		Auditime të realizuara sipas llojit të tyre										Angazhime të përfunduara	Angazhime në proces			
		Shërbime të Sigurisë nga të cilat:						Shërbime Këshillimi	Angazhime me kërkesë të titullarit							
		A. të përpunshëmrisë	A. të performancës	A. financiare	A. tek. Informacionit	A. të kombinuara	Gjithsej									
3.1	3.2	3.3	3.4	3.5	3.6	3.7	4.1	4.2								
a.	1	(3.1+3.2+3.3+3.4+3.5+3.6+3.7) ose (4.1+4.2)														
1	DRKK Durrës	1							1				1			
2	Agjencia e Shërbimit Arkeologjik	1							1				1			
3	Qendra Kombëtare e Muzeve, Berat	1							1				1			
4	Zyra e Adm Koor. Apoloni	1							1				1			
5	Biblioteka Kombëtare	1	1										1			
6	Cirku I Tiranës,	1							1				1			
7	Teatri Komb. I Operas, Baletit	1							1				1			
8	Arkivi Qendror I Filmit	1							1			1				
9	Teatri Kombetar	1							1				1			
10	Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmij	1							1				1			
11	Qendra Kombëtare e Inventarizimit	1							1				1			
12	Muzeu Gjergj Kastrioti Skërdëbeu	1							1				1			
13	Qendra Kombëtare e Veprimtarisë Folklorike	1							1				1			
14	Qendra Realizimit të Veprave të Artit	1							1				1			
Totali		14	1	0	0	0	0	0	13	0	1	12	2			

SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË MINISTRINË E KULTURËS

Rekomandimet e dhëna sipas kategorive për vitin 2017

Nr	Rekomandimet e dhëna sipas prioritetit	Subjekte të Audituar	Statusi i Rek. të dhëna në vitin e mëparshëm	STATUSI I REKOMANDIMEVE				Arsyeja e mos zbatimit	Pasqyra 5 Në numër
				Rekomandim i dhënë	Rekomandim i pranuar nga menaxhimi	Rekomandim i zbatuar	Në proces zbatimi		
a.	1	2	3	4.1	4.2	4.3	4.4	4.5	
I	<i>Rekomandime të përmirësimit e sistemeve</i>								
I	Të hartohet strategjia e menaxhimit të riskut në zbatim të nenit 21, të ligjit të Ligjit 10296, datë 08.07.2010, "për menaxhimin financiar dhe kontrollin", me ndryshime, për të dhënë siguri të arsyeshme në realizimin e objektivave	TK		1	1		1		
						0	1		
	SHUMA 1			1	1	0	1		
	<i>Rekomandime të përmirësimit e kuadrit ligjor</i>								
1	BKSH në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike në MK të propozojnë pranë APP-së ndryshim të procedurave për prokurimin për shërbimin me roje private, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu VII, neni 60 dhe VKM nr.28, datë14.01.2015 "Për ngarkimin e MB për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër e për llogari të Kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë", për shmangjen e procedurave të zgjatura	<i>Biblioteka Kombetare</i>		1	1	1			
	SHUMA 2		0	1	1	1	0		
	<i>Rekomandime të karakterit organizativ</i>								
I	-Institucioni të marrë masat për përditësimin e Manualit të procedurave të organizimit dhe funksionimit të ASHA në përputhje me Rregulloren e miratuar me Urdhër të Ministrit të Kulturës nr. 248, datë 26.06.2015.			1	1	1			

2	- Në zbatim të rregullores së brendshme (neni 2, pika, miratuar me Urdher të Ministrit të Kulturës nr. 248, datë 26.06.2015) në faqen online, http://ëëë.asha.gov.al/?page_id=1139 , në rubrikën aplikime, krahas dy Listave: Lista e shoqërive private të licensuara në arkeologji dhe Lista e individëve privatë të licensuar në arkeologji rekomandojmë që Listat të pajisen edhe me Vendimet e KKA që kanë miratuar licensat përkatëse për subjektet dhe individët e licensuar
3	-Në zbatim të ligjit nr.10296, date 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", I ndryshuar dhe udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar institucioni: Gjatë procesit të inventarizimit në zbatim të këkesave të pikës 99, Kapitulli IV. "Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve Inventarizimi i aktiveve" të Udhëzimit nr. nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" I ndryshuar, titullari të përcaktojë kryetar të Komisionit të vlerësimit, nëpunësin zbatues të institucionit.
4	Titullari I institucionit të bëjë ndarjen e detyrave në zbatim të pikës 29 të VKm nr.893, datë 17.12.2014 "Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmës, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për pregatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm" dhe pika 15 e Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" I ndryshuar, për mirëfunksionimin sa më efektiv të institucionit.Rekomandohet rishikimi i përshkrimeve të punës për punonjësit dhe të reflektohen ne rregulloren e brendshme.
5	-Në zbatim të pikës 3/1, neni 12, Kreu II "Organizimi i prokurimit publik" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe ligjit nr.10296, date 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar dhe akteve nënligjore të bëhen pjesë të proceduarve të prokurimit i gjithë raportit i realizuar nga sistemi elektronik

ASHA

	1	1	1		
	1	1	1		
	1	1	1		
	1	1	1		

6	-Institucioni në zbatim të pjesës V, të Ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil” i ndryshuar, ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik” me ndryshime dhe aktet nënligjore të lidh kontrata shërbimi.		1	1	1		
1	Në zbatim të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor të Republikës së Shqipërisë”, I ndryshuar dhe pikës 48 “Përgjegjësitë e nëpunësit zbatues” të udhëzimit nr.23/2016 ”Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” nëpunësi autorizues të përcaktojë nëpunës zbatues punonjës in e administratës I cili ka varësi direkte prej tij, në pozicion jo më të ulët se sa niveli menjëherë pas tij në strukturën organizative.		1	1		1	
2	Për mirëfunksionimin sa më efektiv të institucionit, të rishikohet struktura ekzistuese në përputhje me kërkesat e Vendimit i KM, nr.893, datë 17.12.2014, “Për përcaktimin e standarteve e të procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike” të propozohet funksioni i Drejtorit artistik dhe të paraqitet për miratim në M.K.		1	1		1	
3	Teatri Kombëtar të miratojë rregulloren e funksionimit, dhe të paraqesë për miratim statutin e institucionit në MK		1	1		1	
4	Në zbatim të ligjit nr. 9154, date 06.11.2003, “Për arkivat” si dhe të Ligjit 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshime, i gjithë dokumentacioni zyrtar dhe artistik i funksionimit të institucionit të protokollohet, arkivohet si dhe të kryhet inventarizimi i plotë i dosjeve.		1	1		1	
5	Në zbatim të ligjit nr.10352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe kulturën”, me ndryshime, të Bordi Artistik të marrë në analizë veprimtarinë artistike, si dhe miratimin e projekteve artistike të shoqëruara me preventive për secilën shfaqje.		1	1		1	
6	-Institucioni të marrë masa për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit sic kërkon neni 12, pika dh,16 dhe 23 të ligjit për MFK, “Gjurma e auditimit përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundimin e tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimarrjen lidhur me to.	TK	1	1	1		

	-Institucioni të hartojnë dhe miratojnë manual të procedurave në drejtim të administrimit të dokumentacionit ligjor dhe artistik.					
7	Në zbatim të kërkesave të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe Ligjit për Kontabilitetin Institucioni të hartojë format tip për kërkesat e bëra nga sektorë për realizimin e projektet artistike dhe të bëhet mbyllja e prodhimit në zbatim të kërkesave të V.K.M nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe të rregullave kontabël” kapitulli I.	1	1	1		
8	Rekomandohet rishikimi i përkrahjeve të punës për të gjithë punonjësit, dhe plotësimi i tyre me nënshkrimin e të gjithë hallkave institucionale. Rekomandohet të bëhen vlerësimet e punës për të gjithë punonjësit administrativë dhe trupës artistike	1	1	1		
